

Llogaritja e ponderit për sistemimin e të siguruarve

Të siguruarit të cilët detyrimisht sistemohen në fondin e detyrueshëm pensional në pajtim me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 180/2019) janë të siguruarit të cilët për herë të parë i qasen sigurimit të detyrueshëm pensional dhe invalidor pas 1 janarit 2019 dhe në datën e qasjes janë më të rinj se 40 vjeç, në pajtim me nenin 118 të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe nuk kishin nënshkruar kontratë për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional me asnjë shoqëri.

Në pajtim me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital dhe Rregulloren për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional, Agjencia çdo muaj përcakton ponderin sipas të cilit bëhet sistemimi i të siguruarve të pasistemuar dhe e dorëzon në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor (Fondi i SPIMV-së) i cili bën sistemimin e të siguruarve me shfrytëzimin e ponderit.

Ponderi për çdo fond të detyrueshëm pensional përcaktohet sipas kontributit në shumën nominale të fondit të detyrueshëm pensional dhe lartësinë e kompensimit nga neni 98 paragrafi (1) pika 4) të Ligjit që e arkëton shoqëria e cila e menaxhon fondin e detyrueshëm pensional (në tekstin e mëtejshëm: kompensimi nga kontributet), me shfrytëzimin e formulës si në vijim:

$$P_i = 0,3 * \frac{1}{N_i} + 0,7 * \frac{R_i}{\sum_{j=1}^n \frac{1}{N_j}}, \quad \text{, në rastin kur të gjithë } R_i > 0$$

përkatësisht,

$$P_i = 0,3 * \frac{1}{N_i} + 0,7 * \frac{R_i + |R_{\min}| + 0,01}{\sum_{j=1}^n \frac{1}{N_{ji}} \sum_{j=1}^n (R_j + |R_{\min}| + 0,01)}, \quad \text{, në rastin kur ekziston } R_i \leq 0$$

ku $i = 1, \dots, n$

P_i është ponderi për fondin e detyrueshëm pensional i

n është numri i fondeve të detyrueshme pensionale

N_i është kompensimi nga kontributet i arkëtuar nga shoqëria e cila e menaxhon fondin e detyrueshëm pensional gjatë muajit paraprak

R_i është kontributi i realizuar në shumën nominale të fondit të detyrueshëm pensional i me gjendjen në ditën e fundit të muajit paraprak për 84 muajt paraprak, i reduktuar në nivel vjetor. Nëse fondi i punon më pak se 84 muaj, ndërsa më tepër se 12 muaj, kontributi në shumën nominale llogaritet për të gjithë muajt për të cilët fondi punon, i reduktuar në nivel vjetor. Nëse fondi punon më pak se 36 muaj, ndërsa më tepër se 12 muaj, atëherë si vlerë për R_i merret vlera më e madhe midis: kontributit në shumën nominale të fondit të detyrueshëm pensional dhe mesatares nga kontributet në shumën nominale të të gjithë fondeve ekzistuese të detyrueshme pensionale duke përfshirë edhe kontributin në shumën nominale të fondit të detyrueshëm pensional. Nëse fondi i punon më pak se 12 muaj, atëherë si vlerë për R_i merret mesatarja nga kontributet në shumën nominale të fondeve ekzistuese të detyrueshme pensionale.

R_{min} është kontributi i realizuar minimal në shumën nominale të të gjitha fondeve të detyrueshme pensionale $R_{min} = \min (R_i)$.

Ponderët shprehën në përqindje, të rrethuar në dy vende decimale.

Shembuj për llogaritjen sipas fondeve:

Shembulli 1.

Ekzistojnë dy fonde të detyrueshme pensionale si në vijim: fondi i detyrueshëm pensional A dhe fondi i detyrueshëm pensional B. Dhe të dy fondet e detyrueshme pensionale punojnë nga 96 muaj. Shoqëritë që i menaxhojnë këto dy fonde të detyrueshme pensionale për muajin që i paraprinë muajit për llogaritjen e ponderit i arkëtojnë kompensimet nga kontributet si në vijim:

- Shoqëria që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional A: $N_1 = 4\%$
- Shoqëria që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional B: $N_2 = 3\%$

Dhe në fund të muajit që i paraprinë muajit për llogaritjen e ponderit, çdo fond i detyrueshëm i ka realizuar kontributet e mëposhtme në shumën nominale, për periudhën përkatëse:

- Fondi i detyrueshëm pensional A: $R_1 = 4,5\%$
- Fondi i detyrueshëm pensional B: $R_2 = 5\%$

Në pajtim me formulën e lartpërmendur e kemi llogaritjen si në vijim:

Meqë kontributet në shumën nominale të të dyja fondeve të detyrueshme pensionale janë pozitive e zbatojmë formulën për rastin e parë:

$$P_i = 0,3 * \frac{\frac{1}{N_i}}{\sum_{j=1}^n \frac{1}{N_j}} + 0,7 * \frac{R_i}{\sum_{j=1}^n R_j}$$

Si rrjedhojë, ponderët janë:

$$P_1 = 0,3 * \frac{\frac{1}{4\%}}{\frac{1}{4\%} + \frac{1}{3\%}} + 0,7 * \frac{4,5\%}{4,5\% + 5\%} = 46,02\%$$

$$P_2 = 0,3 * \frac{\frac{1}{3\%}}{\frac{1}{4\%} + \frac{1}{3\%}} + 0,7 * \frac{5\%}{4,5\% + 5\%} = 53,98\%$$

Shembulli 2:

Ekzistojnë tre fonde të detyrueshme pensionale si në vijim: fondi i detyrueshëm pensional A, fondi i detyrueshëm pensional B dhe fondi i detyrueshëm pensional V. Dhe të tre fondet e detyrueshme pensionale punojnë nga 84 muaj. Shoqëritë që i menaxhojnë këto tre fonde të detyrueshme pensionale për muajin që i paraprinë muajit për llogaritjen e ponderit i arkëtojnë kompensimet nga kontributet si në vijim:

- Shoqëria që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional A: $N_1 = 3\%$
- Shoqëria që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional B: $N_2 = 4\%$
- Shoqëria që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional V: $N_3 = 3,5\%$

Dhe në fund të muajit që i paraprinë muajit për llogaritjen e ponderit, çdo fond i detyrueshëm i ka realizuar kontributet e mëposhtme në shumën nominale, për periudhën përkatëse:

- Fondi i detyrueshëm pensional A: $R_1 = -0,3\%$
- Fondi i detyrueshëm pensional B: $R_2 = -1,6\%$
- Fondi i detyrueshëm pensional V: $R_3 = 0,2\%$

Në pajtim me formulat e lartpërmendura e kemi llogaritjen si në vijim:

Meqë ekzistojnë fonde të detyrueshme pensionale që kanë kontribute negative e zbatojmë formulën për rastin e dytë:

$$P_i = 0,3 * \frac{\frac{1}{N_i}}{\sum_{j=1}^n \frac{1}{N_{ji}}} + 0,7 * \frac{R_i + |R_{\min}| + 0,01}{\sum_{j=1}^n (R_j + |R_{\min}| + 0,01)}$$

Fillimisht llogarisim $R_{\min}$.

$$R_{\min} = \min_i (R_i) = R_2 = -1,6\% \quad \text{prej ku} \quad |R_{\min}| = 1,6\%$$

Si rrjedhojë, ponderët janë:

$$P_1 = 0,3 * \frac{\frac{1}{3\%}}{\frac{1}{3\%} + \frac{1}{4\%} + \frac{1}{3,5\%}} + 0,7 * \frac{-0,3\% + 1,6\% + 0,01}{(-0,3\% + 1,6\% + 0,01) + (-1,6\% + 1,6\% + 0,01) + (0,2\% + 1,6\% + 0,01)} = 37,90\%$$

$$P_2 = 0,3 * \frac{\frac{1}{4\%}}{\frac{1}{3\%} + \frac{1}{4\%} + \frac{1}{3,5\%}} + 0,7 * \frac{-1,6\% + 1,6\% + 0,01}{(-0,3\% + 1,6\% + 0,01) + (-1,6\% + 1,6\% + 0,01) + (0,2\% + 1,6\% + 0,01)} = 20,11\%$$

$$P_3 = 0,3 * \frac{\frac{1}{3,5\%}}{\frac{1}{3\%} + \frac{1}{4\%} + \frac{1}{3,5\%}} + 0,7 * \frac{0,2\% + 1,6\% + 0,01}{(-0,3\% + 1,6\% + 0,01) + (-1,6\% + 1,6\% + 0,01) + (0,2\% + 1,6\% + 0,01)} = 41,99\%$$

Shembulli 3:

Ekzistojnë tre fonde të detyrueshme pensionale si në vijim: fondi i detyrueshëm pensional A, fondi i detyrueshëm pensional B dhe fondi i detyrueshëm pensional V. Fondi i detyrueshëm pensional A dhe fondi i detyrueshëm pensional B punojnë 84 muaj, ndërsa fondi i detyrueshëm pensional V punon 24 muaj. Shoqëritë që i menaxhojnë këto tre fonde të detyrueshme pensionale për muajin që i paraprinë muajit për llogaritjen e ponderit i arkëtojnë kompensimet nga kontributet si në vijim:

- Shoqëria që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional A: $N_1 = 4\%$
- Shoqëria që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional B: $N_2 = 3\%$
- Shoqëria që menaxhon fondin e detyrueshëm pensional V: $N_3 = 3,5\%$

Dhe në fund të muajit që i paraprinë muajit për llogaritjen e ponderit, çdo fond i detyrueshëm i ka realizuar kontributet e mëposhtme në shumën nominale, për periudhën përkatëse:

- Fondi i detyrueshëm pensional A: $R_1 = 5,5\%$

- Fondi i detyrueshëm pensional B: $R_2 = 5\%$
- Fondi i detyrueshëm pensional V: $R_3 = 4\%$

Në pajtim me formulat e lartpërmendura e kemi llogaritjen si në vijim:

Meqë fondin e detyrueshëm pensional A dhe fondin e detyrueshëm pensional B punojnë 84 muaj, ndërsa fondin e detyrueshëm pensional V punon 24 muaj në formulën për llogaritjen e ponderit për kontributin nominal të fondit të detyrueshëm pensional V e zgjedhim vlerën më të madhe se vlera e kontributit në shumën nominale të fondit të detyrueshëm pensional V dhe mesataren nga kontributet në shumën nominale të të tria fondeve të detyrueshme pensionale. Përkatësisht në formulë i shfrytëzojmë vlerat si në vijim:

- për fondin e detyrueshëm pensional A: $R_1 = 5,5\%$
- për fondin e detyrueshëm pensional B: $R_2 = 5\%$
- për fondin e detyrueshëm pensional V:

$$R_3^v = \max\left(R_3; \frac{\sum_{j=1}^3 R_j}{3}\right) = \max(4\%; 4,83\%) = 4,83\%$$

Si rrjedhojë, ponderët janë:

$$P_1 = 0,3 * \frac{\frac{1}{4\%}}{\frac{1}{4\%} + \frac{1}{3\%} + \frac{1}{3,5\%}} + 0,7 * \frac{5,5\%}{5,5\% + 5\% + 4,83\%} = 33,74\%$$

$$P_2 = 0,3 * \frac{\frac{1}{3\%}}{\frac{1}{4\%} + \frac{1}{3\%} + \frac{1}{3,5\%}} + 0,7 * \frac{5\%}{5,5\% + 5\% + 4,83\%} = 34,33\%$$

$$P_3 = 0,3 * \frac{\frac{1}{3,5\%}}{\frac{1}{4\%} + \frac{1}{3\%} + \frac{1}{3,5\%}} + 0,7 * \frac{4\%}{5,5\% + 5\% + 4,83\%} = 31,93\% .$$